

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Dokument i Politikave për Standardet e Shërbimeve Publike në Shqipëri

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Ky dokument i rëndësishëm është publikuar në faqen e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, më datë 24 tetor 2022 me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve jo vetëm nga institucionet shtetërore, por edhe për të gjithë qytetarët dhe bizneset, brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit (datë 21 nëntor 2022), në adresën e koordinatorit për konsultimin publik, Znj. Emerlinda Pema me adresë email: Emerlinda.Pema@kryeministria.al.

3. Metoda e konsultimit

Dokumenti është publikuar në faqen e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, më datë 24 tetor 2022 (brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit) dhe është mbyllur me datë 21 nëntor 2022. Gjithashtu më datë 9 nëntor 2022, ora 15:00-17:00;

Për të patur mundësinë e diskutimit të draft-dokumentit, si dhe për të marrë komente dhe sugjerime nga palët e interesuara, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, organizoi një takim/tryezë diskutimi me të gjitha palët e interesit të përfshira.

Shpërndarja e informacionit në procesin e konsultimit të hapur te palët e përfshira u bë e mundur në mënyrë elektronike, nëpërmjet njoftimit me e-mail; ku palëve iu dërgua ftesa nga koordinatori për konsultimin publik, Znj. Emerlinda Pema.

4. Palët e interesit të përfshira

Gjatë takimit të zhvilluar për konsultimin e dokumentit të politikave, u paraqitën 20 organizata/individë (si më sipërlistuar);

1. SASPAC (z. Ilir Beqja)
2. ADISA
3. IDRA (Znj. Blerta Kalavace)
4. SEI
5. AKSHI
6. STAR III
7. UNDP
8. GADC (Znj. Mirela Arqimandriti)
9. UN
10. AMVV/MB
11. SIGMA
12. IDM (Znj. Rovenia Sulstarova)
13. BANKA BOTËRORE
14. MIA

15. Kabineti – Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve
16. ADB (Znj. Eridana Cano)
17. OECD-SIGMA
18. Bashki të Forta (Znj. Valbona Karakaçi)
19. Ekspertë: Ansi Shundi
20. Nevila Como.

Gjatë hartimit të dokumentit u bashkëpunua me ekspertin e SIGMA-OECD, Znj. Nevila Como.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Komente pati përkatësisht nga:

Z. Ilir Beqja, SASPAC

Znj. Eridana Cano, ADB

Znj. Rovenia Sulstarva, IDM

Znj. Blerta Kalavace, IDRA Research&Consulting

Znj. Mirela Arqimandriti, GADC

Znj. Valbona Karakaci, Bashki të Forta.

Çështja adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
Unifikimi i fjalorit	Përmirësimi i terminologjisë dhe përkufizimeve, në mënyrë që të jenë të harmonizuara me procedurën administrative dhe përafrimin me Bashkimin Evropian për shërbimet, në harmoni me dokumentat e tjerë. Dokumenti trajton vetëm cilësinë e shërbimeve publike administrative dhe jo cilësinë e standardeve të të gjitha shërbimeve	Ilir Beqja – SASPAC Rovena Sulstarova – IDM Albania Blerta Kalavace – IDRA Research & Consulting	Vendimi i pranuar	

	publike. Znj. Sulstarova sugjeroi se, dokumenti ka nevojë për një rishikim për të pasqyruar siç duhet këtë pikë, pasi është konfuz (në disa pjesë përkufizimet dhe konceptet lidhen me shërbimet publike dhe në disa të tjera me shërbimet publike administrative). Z. Beqaj rekomandoi si editim të rëndësishëm në dokument unifikimin e fjalorit (<i>që në titull duhet të jetë Shërbime Publike Administrative</i>). Gjithashtu, theksoi se nevojitet një qartësim nëse dokumentit do t'i referohemi si dokument politik apo dokument strategjik. Ai sugjeroi se emërtimi i dokumentit në nivel më teknik referuar si: Dokumenti i politikave është më i përshtatshëm sesa Dokument politik.			
Platforma SQDNE	Znj. Çano sugjeroi që, Platforma e Ofrimit të Standardeve për të treguar se ku janë standardet e	Eridana Cano – ADB	Vendimi i pranuar	

	shërbimeve publike në Shqipëri duhej të jetë e përfshirë në Dokumentin e Politikave dhe më pas të vijë Instrumenti i Barometrit, që duhet të ketë një kohezion dhe me një instrument shumë të rëndësishëm, i cili është një nga sistemet e platformës së Bashkëqeverisjes, që quhet <i>nota ime</i>. Secili qytetar ka mundësi të hyjë dhe të flasë nëpërmjet disa detajeve teknike se si i është ofruar shërbimi tanimë që shërbimet ofrohen online (pra me prezencën e mjetit të personit) apo për dhe ato të ofruara offline nëpërmjet e-albania, të cilat monitorohen nga SQDNE			
--	--	--	--	--